



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 591 Prot.

Tiranë, më datë 18.02.2020

VENDIM

Nr. 62, datë 19.02.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit “Restaurimi i kishës së “Shën Nikollës” Porto Palermo, Himarë, hartuar nga subjekt i licencuar në restaurim z. Gentian Stratobërdha dhe relacionit të verifikimit në terren për gjetjet arkeologjike nga DSHA dhe Drtk Vlorë, në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi i kishës së “Shën Nikollës” Porto Palermo, Himarë, hartuar nga subjekt i licencuar në restaurim z. Gentian Stratobërdha dhe relacionit të verifikimit në terren për gjetjet arkeologjike nga DSHA dhe DRTK Vlorë;
 2. Gjetjet e konstatuara të dokumentohen dhe regjistrohen pranë IKRTK nga specialistët e DSHA dhe DRTK Vlorë;
 3. Punimet për sistemimin e territorit përreth kishës dhe drenazhimit të saj të ndiqen nga specialistët e DRTK Vlorë;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

